



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar-Shtator 2010

Tetor, 2010

TABELA E PËRMBAJTJES

TREGUESIT FISKALE KRYESORË PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2010	2
Analiza e të ardhurave për periudhën janar-shtator 2010	2
Vështrim i përgjithshëm	2
Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera	4
Taksimi i konsumit (indirekt)	4
Taksimi direkt	6
Taksimi i pasurise	8
Taksat nacionale	8
Të ardhura të tjera nga pushteti vendor	9
Të ardhurat e fondeve speciale	9
Analiza e shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2010	12
Vështrim i përgjithshëm	12
Shpenzimet korrente	13
Shpenzimet e personelit	14
Shpenzimet për interesa	15
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	16
Shpenzimet për subvensione	16
Shpenzimet për fonde speciale	16
Shpenzimet të pushtetit lokal	17
Pagesa e papunësisë	18
Fondi rezervë i buxhetit të shtetit	18
Shpenzimet kapitale	20

TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR-SHTATOR 2010

Gjatë nentemujorit 2010 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 237.8 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 7.7 përqind më të larta se e njëjta periudhe e një viti më parë. Në këtë periudhë, shpenzimet totale arritën në 260.1 miliardë leke (shih tabelen 1). Në linjë me politikën fiskale stabilizuese të Qeverisë, dhe në vijim të rishikimit në ulje të shpenzimeve për 2010 kundrejt buxhetit (rishikim që u finalizua me miratimin e buxhetit të ri në Korrik 2010), shpenzimet për nëntëmujorin janë 3.6 përqind më të ulëta se në periudhën nëntëmujore të 2009, dhe 6.6 miliardë më të ulëta se planifikimi sipas buxhetit të rishikuar. Ulja e shpenzimeve gjatë 2010 kundrejt një viti më parë reflektohet më shumë në shpenzimet kapitale, që janë reduktuar me rreth 33.7 përqind në bazë vjetore, ndërsa ato korente janë rritur me 8.7 përqind në bazë vjetore.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 22.4 miliardë për këtë periudhë të 2010, me rënie të ndjeshme kundrejt të njëjtës periudhë të 2009 (49 miliardë lekë ishte deficiti fiskal i nëntëmujorit të një viti më parë). Për këtë periudhë, deficiti ishte planifikuar në 30.1 miliardë lekë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 236 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 16.6 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 5.6 miliardë lekë.

Tabela 1. Treguesit kryesore të buxhetit të konsoliduar për periudhën Janar-Shtator

Miliardë lekë	Janar-Shtator '09	Janar-Shtator '10
TE ARDHURAT TOTALE	220.8	237.8
SHPENZIMET TOTALE	269.9	260.1
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	199.3	216.6
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	70.5	46.8
BALANCA FISKALE	-49	-22.4
BALANCA PRIMARE	-25.6	+7.8

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2010

Vështrim i përgjithshëm

Gjate periudhes nentemujore 2010 jane mbledhur gjithsej ne buxhetin e konsoliduar rreth 237.8 miliarde leke, duke u rritur me 7.7 perqind ne baza vjetore (kundrejt 2009). Ne grupin e te ardhurave tatimore, qe perbejne rreth 90 perqind te totalit te te ardhurave ne buxhet, te ardhurat nga tatimet dhe doganat jane 165.7 miliarde dhe jane rritur me 6.3 perqind kundrejt 2009; te ardhurat nga pushteti vendor jane 8.7 miliarde per periudhen, duke u ulur me 8.3 perqind; te ardhurat nga fondet speciale jane 39.6 miliard me rritje vjetore 6.1 perqind. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010, ka patur një rritje vjetore të të ardhurave ne buxhet prej 13.5 përqind mbi baza vjetore (duke e krahasuar me tremujorin e tretë të 2009). Rritja vjetore gjate tremujorit te parë dhe të dytë gjatë 2010 ka qënë respektivisht 1.3 dhe 7.1 përqind. Pra tremujori i tretë ka nje rritje të dukshme të të hyrave në buxhet krahasuar me dy tremujorët e parë të vitit.

Ecuria e te ardhurave nga tatimet dhe doganat gjate vitit 2010 tregon per permiresim te situates se mbledhjes se tyre gjate muajve te fundit krahasuar me muajt e pare te vitit, sic pasqyrohet dhe ne tabelat me poshte. Sipas agjencive te mbledhjes, per nga te ardhurat e realizuara kundrejt parashikimeve dhe kundrejt nje viti me pare administrata doganore paraqitet me mire per periudhen, me 87.3 miliarde leke te mbledhura, ne linje me parashikimet ne buxhet dhe me rritje 12.2 perqind kundrejt nentemujorit te 2009. Sipas zerave te te ardhurave qe mbledhin doganat bie ne sy performanca e rentes minerare ne eksport, qe eshte rritur me rreth tre here, kryesisht si pasoje e rritjes sw eksporteve si dhe ndryshimeve ne normen e taksimit dhe ne strukturen e takses gjate gjysmes se pare te vitit 2010. Edhe te ardhurat nga akciza ne dogane kane rritje vjetore te ndjeshme me 19 perqind, ne vijim edhe te ndryshimeve ne listen e mallrave me akcize ne mesin e ketij viti. Ndersa te ardhurat nga TVSH ne import jane 12.2 perqind me te larta se nje vit me pare, ndikuar nga ri-gjallerimi i importeve gjate ketij viti (rritja e importeve per 9 mujorin eshte 10.9 perqind, ne vlere) dhe pjeserisht nga efekti i rritjes se akcizes per disa mallra.

Tabela 1. Te ardhurat sipas tremujoreve (miliarde leke)


Emertimi	Trem I 09	Trem II 09	Trem III 09	Trem IV 09	Trem I 10	Trem II 10	Trem III 10
Te ardhura gjithsej	71.8	72.2	76.1	77.2	72.7	77.3	87.7
Te ardhura tatimore	63.9	68.0	70.8	67.6	65.2	71.6	77.2
Nga tatime dhe dogana	47.8	51.7	56.3	53.1	49.2	54.7	61.7
Fondet speciale	13.0	12.5	11.9	11.8	13.3	13.2	13.1
Te ardhura pushteti vendor	3.0	3.9	2.6	2.6	2.7	3.6	2.4

Tabela 2. Te ardhurat sipas tremujoreve (rritja kundrejt te njejtimit tremujor te nje viti me pare)

Emertimi	Trem I 10	Trem II 10	Trem III 10
Te ardhura gjithsej	1.1	7.1	15.3
Te ardhura tatimore	2.0	5.2	9.0
Nga tatime dhe dogana	2.8	5.9	9.7
Fondet speciale	1.8	5.8	9.9
Te ardhura pushteti vendor	-9.8	-6.1	-10.0

Administrata tatimore ka hasur me shume veshtiresi ne mbledhjen e te ardhurave gjate ketij viti, dhe ka mbledhur per periudhen te njejtimit nivel te ardhurash me nje vit me pare, duke tejkaluar gjithsesi parashikimin janar shtator 2010. Tatimet kane patur nje ulje te ndjeshme kundrejt 2009 te te ardhurave nga TVSH, e cila reflekton rritjen e ndjeshme te kontributit te eksporteve ne shitjet totale te bizneseve qe paguajn TVSH krahasuar me strukturwn historike (eksportet kanw TVSH zero).

Figura 1. Te ardhurat ne buxhetin e konsoliduar janar-shtator



Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

Taksimi i konsumit (indirekt)

Tatimi mbi vleren e shtuar


TVSH ka mbledhur gjithsej per nëntëmujorin 84.3 miliardë leke, ose 3.9 përqind me shume se nje vit me pare. Gjatë tremujorit të tretë janë mbledhur nga ky tatim 4.9 përqind më shumë të ardhura se në tremujorin e tretë të 2009.

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 62.3 miliardë lekë, duke realizuar planin e periudhës. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 73.8 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë 6 miliardë lekë më shumë ose 10.7 përqind. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara dhe çmimet në import) si dhe kursi i këmbimit të lekut me monedhat kryesore të tregtisë ndërkombëtare të Shqipërisë, Euro-s dhe Dollar-it. Sipas të dhënave të INSTAT për tregtinë e jashtme, importet në vlerë janë rritur me 10.9 përqind kundrejt një viti më parë, të ndikuara edhe nga rritja e çmimeve në import për mallrat kryesore dhe nga efekti i kursit të këmbimit (mesatarisht leku është zhvlerësuar me 6 përqind kundrejt një viti më parë ndaj Euro-s dhe 9 përqind ndaj Dollar-it). Kontributin me te lartë për rritjen e importeve për nëntëmujorin e kanë patur këta artikuj: minerale, lëndë djegëse; ushqime, pije, duhan; tekstile dhe këpucë, materiale ndërtimi dhe metale. ndërsa në ulje vazhdojnë të jenë gjatë këtij viti importet e makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi, me 7 përqind më pak se gjatë 2009.

Nga administrata tatimore për periudhën Janar - Shtator janë mbledhur 22.1 miliardë lekë nga 23.9 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë 7.8 përqind më pak. Të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 27.3 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime janë ulur me 2.9 miliardë lekë, ose 11.5 përqind. Në grafikun më poshte paraqiten të ardhurat nga TVSH-ja për nëntëmujorin në vite. Për periudhën tetëmujore, subjektet tatimpagues të TVSH janë në total 19,384 (xhiro vjetore mbi 5 milionë lekë), ndërsa për vitin 2009 ato ishin 18,022 njësi. Tregtia dhe shërbimi përbëjnë sektorët dominues, me 67 përqind të të gjithë subjekteve me TVSH. Rimbursimi i

TVSH-se per periudhen nentemujore ka arritur shifren 5.9 miliarde leke nga 2.2 miliarde qe ishte nje vit me pare.

Figura 2. Te ardhurat nga Tatimi mbi Vleren e Shtuar janar-shtator



Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Shtator janë rreth 5.2 miliardë lekë, sipas parashikimeve; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 532 milionë lekë, ose 9.4 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.8 përqind. Lidhur me tarifat preferenciale, gjatë këtij viti po zbatohen reduktimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA), me Turqinë dhe me vendet e Bashkimit Europian.

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Shtator arritën në rreth 28.6 miliardë lekë duke shënuar rritje të konsiderueshme prej 10.4 përqind në krahasim me të njëjtën periudhë të një vit më parë, ose 2.7 miliardë lekë më shumë. Gjatë tremujorit të tretë të 2010 të ardhurat nga akciza patën një rritje vjetore prej 4.6 përqind, ndërkohë që gjatë 2010 periudha me e mire për mbledhjen e kësaj takse ka qenë tremujori i dytë i vitit me rritje vjetore 39.6 përqind. Lidhur me ndryshimet ligjore që kanë përfshirë akcizën, kujtojmë se në shtator të vitit 2009 u rrit akciza e kafes (e papjekur nga 50 lek në 70 dhe e pjekur nga 100 në 140 leke për kg); u rrit akciza e cigares (nga 40 lek për pakete në 50 lek); ndërsa në qershor të vitit 2010 ndryshimet ishin akoma më të ndjeshme: u ul akciza mbi kafën e papjekur (nga 70 lek në 30 lek për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli "naftë virgin" me nivel akcize 50 lek për litër, shtohen në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarret, gomat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshon taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Ndryshimet më thelbësore për nga impakti mbi të ardhurat kanë një kohë të shkurtër aplikimi (që nga korriku i vitit në vijim) dhe analiza e efektit neto të tyre është e vështirë. Megjithatë, për më shumë qartësi, në vijim janë pasqyruar të ardhurat sipas artikujve dhe sipas agjencive të mbledhjes.


Nga administrata doganore janë mbledhur rreth 18.3 miliardë lekë, që përbëjnë 61 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza gjithsej. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birres së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (psh mallrat që i janë shtuar listës). Në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga akciza në doganë janë 2.9 miliardë lekë më shumë, ose rreth 19 përqind. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata për periudhën ka qënë si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuar për periudhën Janar - Shtator 2010 është 362 mije ton, me rritje 8 përqind dhe të ardhura 21.5 përqind më të larta (16.3 miliardë ose 89 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza në doganë); sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar - Shtator 2010 është 3.1 mijë ton, me një ulje prej rreth 7 përqind; sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar - Shtator 2010 është 28.8 milionë litra, me një rënie prej 3 përqind, ndërsa të ardhurat e mbledhura nga Dogana për pijet alkoolike kanë qënë 8.5 përqind më ulët se një vit më parë; kafeja e zhdoganuar për periudhën ka qënë 12 përqind më pak. Të ardhurat e mbledhura nga kafeja dhe të tjera (duke përfshirë këtu mallrat e reja të listës) ka patur një rritje të ndjeshme prej 59.5 përqind duke arritur nivelin 1.6 miliardë lekë.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 10.4 miliardë lekë, me rënie vjetore 2.4 përqind. Të ardhurat nga akciza të mbledhura nga tatimet përbëjnë rreth 39 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Sipas grup mallrave, të ardhurat nga karburantet e prodhuara në vënd kanë pësuar një ulje prej 57 përqind si pasoje e ngadalesimit të aktivitetit të ARMO gjatë këtij viti; të ardhurat e mbledhura nga cigaret, përmes pullave fiskale, janë rritur me 11.4 përqind, si pasojë e rritjes së nivelit të taksimit të cigareve në Shtator 2009; të ardhurat e mbledhura nga pijet alkoolike me pullë akcize kanë qëndruar pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 3. Të ardhurat nga akciza sipas mallrave

Të ardhura, miliardë lekë	9 mujor 2009	9 mujor 2010	Ndryshimi %
Akciza mbi cigaret	7.3	8.2	+11.4
Akciza karburante	16.1	17.4	+8.3
Akciza pije alkoolike	1.5	1.4	-6.5
Të tjera	1.0	1.6	+63.2

Figura 3. Të ardhurat nga Akciza janar-shtator



Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 19.9 miliardë lekë, duke qënë 1.6 përqind më të ulëta se e njëjta periudhë e një viti më parë. Në tremujorin e tretë të 2010 të ardhurat nga TAP janë rritur mbi baza vjetore me 13.8 përqind (dmth krahasuar me tremujorin e tretë të 2009) dhe 18.6 përqind kundrejt tremujorit te dytë të 2010.

Sipas burimit të të ardhurave, të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qënë rreth 5.5 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 4 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qënë 5.3 miliardë lekë me rritje prej 13 përqind; të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 1.8 miliardë lekë, pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 4. Të ardhurat nga taksimi individual sipas burimit të të ardhurave


Të ardhura, miliardë lekë	9 mujor 2009	9 mujor 2010	Ndryshimi %
Paga sektori publik	5.8	6.2	+6.1
Paga sektori jo publik	5.3	6.0	+12.9
Interesa	2.4	2.3	-1.1
Dividendë	0.7	1.2	+65.8
Shitje pasuri e paluajtshme	1.6	1.8	+12.7
Të tjera	4.4	2.4	-46.2

Në uljen e nivelit të të ardhurave të mbledhura nga tatimi mbi te ardhurat personale krahasuar me vitin 2009 ka ndikuar zëri i të ardhurave të mbledhura mbi çmimin e shitjes në privatizimet e kompanive shtetërore (në masën 10 përqind). Gjatë vitit 2009 të ardhurat nga privatizimi për periudhën nëntëmujore ishin 1.8 miliardë lekë, kundrejt zero lekë të këtij viti.

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për nëntëmujorin 2010 arritën në rreth 13.1 miliardë lekë nga 12.8 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të lehtë prej 2.3 përqind. Muaji Gusht ka patur ecurinë më të mirë në mbledhjen e këtij tatimi gjate 2010, me një rritje të të ardhurave prej 68 përqind kundrejt muajit gusht të një viti më parë. Vecanerisht gjate shtatemujorit te pare te 2010 mbledhja e te ardhurave te tatim fitimit ka qene ndjeshem nen nivelin e pritshem per arsye te rishikimit ne ulje te kesteve te parapagimit nga subjektet tatimpagues, si dhe te rritjes se teprices kreditore te tatim fitimit krahasuar me nje vit me pare. Mbledhja e tatimit eshte permiresuar ndjeshem gjate muajit gusht dhe shtator. Në tremujorin e tretë të ardhurat nga ky grup tregojnë rritje vjetore prej 15.7 përqind. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga tatim fitimi dhe tatimi mbi të ardhurat personale për nëntëmujorin në vite.

Figura 4. Te ardhurat nga taksimi direkt janar-shtator



Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.8 miliardë lekë nga 1.9 miliardë të një viti më parë, me ulje 4.3 përqind. Nga të dhënat e DPT për numrin e tatimpaguesve subjekte të kësaj takse, për tetëmujorin kjo shifër është 59,170 nga 56,842 tatimpagues të 2009, dmth me rritje 4.1 përqind.

Taksimi i pasurise

Per qellime analize, ketu perfshijme tatimin mbi ndertesat, mbi token bujqesore dhe taksen e kalimit te pasurise se paluajtshme. Eshte prej kohesh nje pjese problematike e sistemit tatimor, persa i takon te ardhurave te mbledhura kundrejt te ardhurave potenciale qe mund te mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i takses mbi pasurine rezulton te jete pergjithesisht efektiv persa i perket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek te njejten tendence ne arritjen e nivelit te parashikuar te te ardhurave me taksat dhe tarifate tjera te aplikueshme nga njesite vendore (tarifat e pastrimit, gjelberimit, ndrçimit). Nderkohe , eksperiencia nuk eshte e njejte per kategorine "Familjare" te taksapaguesve. Ketu tendenca ne grumbullimin e kesaj takse eshte e ulet, dhe njesite e qeverisjes vendore kane mjaft probleme ne administrim dhe ne detyrimin per pagimin e takses. Per nivelin ende te larte te informalitetit, ka mjaft veshtiresi ne vleresimin e bazes se taksueshme, per arsye te mangesive ne deklarimin real te pasurive. Per nentemujorin taksat mbi pasurine arrijne ne 1.5 miliarde leke, ose 9.8 perqind me te larta se nje vit me pare. Ne totalin e te ardhurave tatimore ky grup taksash ze vetem 0.71 perqind, kundrejt 6 perqind qe eshte mesatarja e vendeve te OSBE


Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën, janë 14.5 miliardë lekë nga 12.1 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Shtator. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 4.6 miliardë lekë, ose 46.3 përqind. Me te rendesishmet ne kete grup jane: taksa mbi transakcionin e makinave te perdorura, te ardhurat nga te cilat jane ne renie me 7 perqind kundrejt periudhes janar-shtator 2009; taksa e qarkullimit rrugor, me 3.2 miliardë (pak a shumë i njëjti nivel me një vit më parë); taksa e rentes minerare, qe ka nje rritje te ndjeshme te te ardhurave prej 90 perqind mbi baza vjetore dhe nga e cila janë mbledhur 2.4 miliardë lekë për periudhën; taksat mbi lojrat e fatit, edhe keto me rritje te ndjeshme te te ardhurave prej 67.9 perqind kundrejt te njejtës periudhe te nje viti me pare, me 3.9 miliardë të ardhura.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Shtator arritën në 8.7 miliardë lekë nga 10.2 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për 2010, ndërsa kundrejt nëntëmujorit të parë të vitit 2009 të ardhurat janë ulur me 791 milionë lekë (rreth 8.3 përqind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 5.3 miliardë lekë nga 6.4 të parashikuara, dhe 16.7 përqind më pak se vitin e kaluar. Në tremujorin e tretë të 2010 të ardhurat nga taksat vendore rezultojnë me një rënie vjetore prej 10 përqind, ecuria më e dobët ndër të gjithë tremujorët e 2010. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga taksat vendore (gjithsej) për nëntëmujorin e parë në vite.

Figura 5. Të ardhurat nga taksat vendore janar-shtator



Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën Janar - Shtator 2010 arritën në 39.6 miliardë lekë, me një rritje prej 6.1 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 38.2 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në tremujorin e tretë të 2010 të ardhurat nga ky grup paraqisnin një rritje vjetore prej 9.9 përqind, kundrejt tremujorit të tretë të 2009.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 33.3 miliardë lekë, gati në të njëjtin nivel të vitit 2009; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 4.9 miliardë lekë, 24.1 përqind më shumë se nëntëmujori i një viti më parë. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për këtë periudhë rezulton se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 2.9 përqind, ose 10,777 njësi, kundrejt mesatares vjetore të 2009 dhe 3.2 përqind më shumë se nëntëmujori i 2009. Për sektorin privat rritja e numrit të të punësuarve (mesatare 9-mujor 2010 kundrejt mesatares 12 - mujor 2009) është 4.9 përqind ose afërsisht 11 mijë kontribues më shumë. Megjithatë, brenda kësaj shifre, *subjektet me TVSH kanë një rritje të kontribuesve prej 6.3 përqind* ndërsa subjektet e biznesit të vogël një rritje më modeste prej 1.3 përqind. Numri mesatar i kontribuesve në sektorin publik (buxhetorë dhe ndërmarrje shtetërore) rezultojnë i njëjtë me mesataren e vitit 2009.

Figura 6. Te ardhurat ne Fondet Speciale janar-shtator




Tabela 5. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik


	EMERTIMI	9 Mujor 2009 mln leke	9 Mujor 2010 mln leke	%	Kundrej t planit %
	TE ARDHURAT NE BUXHETIN E KONSOLIDUAR	220,819	237,752	7.7	0.5
A	Te ardhura tatimore	202,571	213,942	5.6	-0.5
I	Tatimet mbi te ardhurat	34,922	34,815	-0.3	-0.04
<i>I.1</i>	<i>Tatimi mbi te ardhurat personale, nga I cili:</i>	<i>20,256</i>	<i>19,941</i>	<i>-1.6</i>	<i>-0.8</i>
	Tatimi mbi pagen ne sektorin publik	5,821	6,177	6.1	
	Tatimi mbi pagen ne sektorin jopublik	5,296	5,980	12.9	
	Tatimi mbi te ardhurat nga interesat	2,355	2329	-1.1	
	Tatimi mbi te ardhurat nga dividendet	746	1237	65.8	
	Tatimi mbi te ardhurat nga shitja e pasurise	1648	1858	12.7	
	Te tjera	4390	2360	-46.2	
<i>I.2</i>	<i>Tatimi mbi te ardhurat nga biznesi</i>	<i>14667</i>	<i>14874</i>	<i>1.4</i>	<i>0.99</i>
	Tatim fitimi	12777	13066	2.3	4.9
	Taksa mbi biznesin e vogel	1889	1808	-4.3	-20.4
II	Te ardhurat ne fondet speciale	37289	39577	6.1	-0.3
III	Taksimi i pasurise	1390	1526	9.8	
	Tatimi mbi ndertesat	949	1075	13.2	
	Tatimi mbi token bujqesore	270	304	12.6	
	Taksa mbi kalimin e pasurise	170	147	-13.8	
IV	Taksat indirekte mbi mallrat dhe sherbimet	107146	112981	5.5	
IV.1	Tatimet mbi shitjen	81200	84343	3.9	-2.2
	TVSH mbi shitjet brenda vendit	24928	22042	-11.6	-7.8
	TVSH mbi mallrat e importuara	56272	62302	10.7	0.0
IV.2	Akcizat	25946	28638	10.4	-0.7
	Mbi karburantet	16078	17411	8.3	
	Mbi alkoolin dhe nenproduktet e tij	1544	1443	-6.5	
	Mbi duhanin dhe nenproduktet e tij	7342	8178	11.4	
	Te tjera (kafe, etj)	984	1606	63.2	
V	Taksimi i automjeteve	3718	3807	2.4	
	Taksa per regjistrimin e automjeteve	520	582	11.8	
	Taksa e qarkullimit rrugor	3198	3226	0.9	
VI	Te tjera taksa mbi mallra dhe sherbime (nacionale)	6720	11288	68.0	
	Taksa e karbonit (ne fuqi deri ne korrik 2010)	389	757	94.8	
	Taksa e ambalazheve per lengjet (deri ne korrik 2010)	127	170	33.6	
	Taksa mbi transaksionet e makinave te perdorura	2108	1961	-7.0	
	Taksa portuale	1.1	0.6	-47.3	
	Renta minerare	1276	2433	90.8	
	Taksa e pulles dhe akteve	508	502	-1.2	
	Taksa per regjistrimin e lojrave te fatit	7	4	-42.9	
	Taksa per ushtrimin e veprimtarise se peshkimit	12.3	10.4	-15.2	
	Taksat mbi kazinote dhe lojrat e fatit	2293	3850	67.9	
VII	Taksat mbi tregtine nderkombetare	5686	5154	-9.4	-2.9
VIII	Te tjera taksa lokale	5700	4793	-15.9	
B	Te ardhura jo tatimore	16127	21530	33.5	14.3
C	Grante	2121	2280	7.5	-19.3

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – SHTATOR 2010

Vështrim i përgjithshëm

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të nëntemujorit 2010, arriten në rreth 260.1 miliardë leke, nga rreth 266.8 miliardë leke të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 97.5 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 6.6 miliardë leke. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 70.0 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtes periudhe të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 9.7 miliardë leke më pak ose rreth 3.6 përqind më të ulta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute, ritmi i rritjes së tyre gjatë nëntemujoreve, në disa vite, si dhe ritmi linear i rritjes, jepet në grafikun e mëposhtëm:

Figura 7. Shpenzimet e përgjithshme janar-shtator



Në analizën e shpenzimeve **duhet mbajtur parasysh edhe fakti** se deri në fund të nëntemujorit 2010, shpenzimet e kryera nëpërmjet përdorimit të fondit rezerve të Keshillit të ministrave dhe kontigjencës, janë reflektuar në zerat e shpenzimeve ku ato janë kryer, si më poshtë:

Fondi rezerve i Keshillit të Ministrave prej rreth 1920.4 milionë leke, i ekzekutuar deri në fund të nëntemujorit 2010, është përdorur në rreth 22.8 milionë leke për shpenzime për paga, në rreth 3 milionë leke në shpenzime për sigurime shoqërore, në rreth 500 milionë leke për subvencione, në rreth 873.6 milionë leke për shpenzime të tjera korrente dhe në rreth 521.1 milionë leke për investime.

Fondi i kontigjencës prej 2.7 miliardë leke, i ekzekutuar deri në fund të nëntemujorit 2010 është përdorur në rreth 1.5 miliardë leke për shpenzime operative dhe të mirembajtjes dhe rreth 1.2 miliardë leke për subvencion.

Shpenzimet e përgjithshme sipas elementeve kryesore përberës të tyre, realizuar gjatë periudhës janar-shtator 2000-2010, me milionë leke, jepet në tabelën e mëposhtme:


SHPENZIMET NE VITE

ne milion leke

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
TOTALI I SHPENZIMEVE	116,355	127,967	129,187	139,939	151,330	161,795	152,236	171,725	220,169	269,863	260,132
I. Shpenzime Korrente	95,163	99,560	108,076	119,788	130,328	138,951	137,310	146,622	169,564	199,253	216,589
1 Personeli	23,353	28,785	28,910	30,816	34,409	38,125	39,492	40,090	46,344	45,441	47,770
2 Interesat	24,396	18,147	18,011	22,477	23,071	20,576	19,438	18,405	23,019	25,630	30,054
3 Shpenzime Operative Mirembajtje	11,826	10,830	13,986	15,436	16,280	16,744	13,410	15,097	16,624	20,637	23,257
4 Subvecionet	2,735	4,975	5,243	2,843	3,224	2,564	1,725	1,766	1,506	1,541	3,151
5 Shpenzime per Sig.Sociale	22,708	26,110	29,151	32,402	36,616	40,600	43,433	50,581	55,423	70,635	77,489
6 Buxheti lokal	3,925	4,473	6,752	9,863	10,149	12,941	12,615	12,508	17,196	23,615	21,666
7 Shpenzime te tjera	6,220	6,240	6,023	5,951	6,579	7,401	7,197	8,175	9,452	11,243	13,202
II. Shpenzime Kapitale	20,444	26,965	21,111	20,151	21,002	22,844	14,926	21,353	45,450	70,525	46,759
1 Financimi Brendshem	11,054	14,836	10,532	11,669	13,928	15,447	11,233	15,821	19,376	57,694	35,167
2 Financimi Huaj	9,102	12,129	10,579	8,482	7,074	7,397	3,693	5,532	26,074	12,831	11,592

Ne totalin e shpenzimeve buxhetore te realizuara, gjate nentemujorit 2010, shpenzimet korente zene rreth 83.3 perqind, nderkohe qe shpenzimet per investime zene rreth 17.9 perqind (diferenca eshte huadhenia neto, me rreth -1.2 perqind). Nje vit me pare struktura e shpenzimeve te pergjithshme te buxhetit te shtetit te realizuara gjate periudhes janar-shtator, ishte rreth 73.8 perqind shpenzimet korente dhe rreth 26.2 perqind shpenzimet kapitale.


Figura 8. Struktura e shpenzimeve janar-shtator



Shpenzimet Korrente

Shpenzimet korente ne fund te muajit shtator 2010, kane arritur ne rreth 216.6 miliarde leke dhe krahasuar me planin vjetor keto shpenzime jane realizuar ne rreth 71.8 perqind, nderkohe qe krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar, keto shpenzime rezultojne rreth 17.3 miliarde leke me te larta ose rreth 8.7 perqind me shume.

Figura 9. Shpenzimet korente janar-shtator




Sipas zerave perberes te shpenzimeve korente, situata e realizimit te tyre ne fund te muajit shtator 2010, paraqitet si ne tabelen e meposhtme:

	Shpenzimet korente	Parashikimi janar-shtator 2010 ne mln leke	Realizimi janar-shtator 2010		
			Ne milion leke	Ne %	Struktura ne %
1	Shpenzime personeli	48918	47770	97.7	22.1
2	Interesa	30455	30054	98.7	13.9
3	Shpenz oper, mirembajtjes	22310	23257	104.2	10.7
4	Subvensionet	1387	3151	227.2	1.5
5	Shpenzimet per fonde speciale	78268	77489	99.0	35.8
6	Shpenzimet buxh vendore	21477	21666	100.9	10.0
7	Shpenzime te tjera	13626	13202	96.9	6.0
	Totali i shpenzimeve korente	216441	216590	100.1	100.0

Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korente, **shpenzimet e personelit**, qe perfaqesojne rreth 22.1 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate periudhes janar-shtator 2010, rezultojne me nje mosrealizim prej rreth 1.1 miliard leke ose rreth 97.7 perqind te parashikimit te periudhes. Kundrejt planit vjetor keto shpenzime ne fund te muajit shtator jane realizuar ne rreth 71.5 perqind te tij, nderkohe qe krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare shpenzimet e personelit rezultojne rreth 2.3 miliard leke me te larta, ose rreth 5.1 perqind me shume.

Figura 10. Shpenzimet per personelin janar-shtator




Shpenzimet per paga jane rreth 396 milione leke me pak se parashikimi i periudhes, duke qene ne te njejten kohe rreth 3.1 miliardë leke me te larta se nje vit me pare ose rreth 8.0 perqind me shume se nje vit me pare, nderkohe qe shpenzimet per sigurimet shoqerore jane rreth 730 milione leke me pak ose rreth 10.2 perqind me te ulta, se nje vit me pare.

Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet per interesa qe perfaqesojne rreth 13.9 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate periudhes janar-shtator 2010, rezultojne me nje kursim prej rreth 401 milione leke, rrjedhoje kjo e kursimit per rreth 137 milione leke ne interesat e brendeshme dhe rreth 264 milione leke ne interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat jane realizuar ne rreth 69.1 perqind, ndersa krahasuar me nje vit me pare ato rezultojne rreth 4.4 miliardë leke me te larta ose rreth 17.3 perqind me shume. Ecuria e shpenzimeve per interesa gjate nente muajve te pare, ne vite jepet nga grafiku i meposhtem:


Figura 11. Shpenzimet per interesa janar-shtator



Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes qe perfaqesojne rreth 10.7 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate periudhes janar-shtator 2010, arriren ne rreth 23.3 miliarde leke ose rreth 75.5 perqind te planit vjetor. Ne te njejten kohe ato rezultojne rreth 2.6 miliarde leke ose rreth 12.7 perqind me shume se nivelet e realizimit te vitit te kaluar.


Figura 12. Shpenzimet O&M janar-shtator



Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet per subvencione ne fund te muajit shtator 2010 arriren ne rreth 3.2 miliarde, rrjedhoje kjo e shlyerjes se detyrimeve te prapambetura te ndermarrjeve te ujesjellesve per energjine elektrike, per te cilen ne masen 500 milione leke eshte perdorur fondi rezerve i buxhetit te shtetit dhe ne rreth 1.2 miliarde leke fondi i kontigjences.

Figura 13. Shpenzimet per subvencione janar-shtator




Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet per fonde speciale gjate periudhes janar-shtator 2010 rezultojne rreth 779 milione leke me pak apo rreth 1 perqind nen nivelin e parashikimit te periudhes. Kjo situatë është rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve në sigurimet shoqerore prej rreth 780 milione leke, e mosrealizimit të shpenzimeve për sigurimet shendetesore prej rreth 190 milion leke dhe e tejkalimit të shpenzimeve për kompensimin e ish pronareve me rreth 191 milione leke krahasuar me parashikimin e periudhes. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 71.2 perqind, nga të cilat sigurimet shoqerore janë realizuar në rreth 71.3 perqind të planit vjetor, sigurimet shendetesore janë realizuar në rreth 71.3 perqind të ketij plani dhe kompensimi i pronareve në rreth 61.2 perqind.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqerore rezultojne rreth 4.0 miliarde leke me të larta ose rreth 7.3 perqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shendetesore rezultojne rreth 1.9 miliarde leke me të larta, ose rreth 11.3 perqind më shumë.


Figura 14. Shpenzimet për sigurime shoq.&shend janar-shtator



Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet e pushtetit lokal zene 10.0 perqind të shpenzimeve korente. Për periudhën janar-shtator 2010 ato kanë arritur në rreth 21.7 miliarde leke ose rreth 189 milione leke më shumë se niveli i planifikuar për këtë periudhë të vitit 2010. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 71.3 perqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojne rreth 1.9 miliarde leke më të ulta ose rreth 8.3 perqind më pak. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit lokal për periudhën janar-shtator për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.

Figura 15. Shpenzimet për pushtetin lokal janar-shtator




Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunesise rezulton ne rreth 82.1 perqind e planifikimit vjetor, duke qene rreth 25.8 perqind me shume se ne nentemujorin e vitit te kaluar.

Ndihma ekonomike gjate periudhes janar-shtator 2010 rezulton rreth 374 milione leke me pak ose rreth 3.0 perqind nen parashikimin e periudhes, duke qene ne te njejten kohe rreth 69.9 perqind e planit vjetor.

Figura 16. Shpenzimet per mbrojtjen sociale janar-shtator



Deri ne fund te muajit shtator 2010 nje fond prej rreth 1 041 milione leke eshte dhene per **kompensimin ne vlere te ish te perndjekurve politike**, fond i cili perfaqeson rreth 61.2 perqind te planifikimit vjetor.

Fondi rezervë i buxhetit të shtetit

Deri ne fund te nentemujorit 2010, **fondi rezerve i buxhetit te shtetit**, eshte prekur nepermjet 64 vendimeve te Keshillit te Ministrave, ne shumen prej rreth 2.1 miliarde leke, nga 2.5 miliarde leke te planifikuar per t'u perdorur, ose rreth 84.8 perqind e tij.

Ne milione leke

	Parashikuar për vitin 2010	Përdorur me vendime të KM	Ekzekutuar	Përqindja (Përdorur/parashikuar)
Fondi Rezervë	2500.0	1895.3	1842.8	75.8

Nga 64 vendime te Keshillit te Ministrave te miratuar per perdorimin e fondit rezerve deri ne fund te muajit shtator 2010, vetem vendimi "Per miratimin e marreveshjes se rinovuar, ndermjet KM te RSH dhe shoqerise Microsoft Corporation, per projektin e partneritetit strategjik ne fushen e informacionit " nuk ishte ekzekutuar ende.

Nga fondi i ekzekutuar, prej rreth 1.92 miliarde leke, rreth 1.35 perqind eshte perdorur per shpenzime personeli, rreth 26.04 perqind per subvencion, rreth 45.49 perqind per shpenzime te tjera korente dhe rreth 27.14 perqind per investime, sic duket edhe nga tabela dhe grafiku i meposhtem.

Fondi rezerve i Keshillit te Ministrave, sipas zerave te shpenzimeve:

		Fondi rezerve i ekzekutuar	
		Ne milione leke	Ne perqindje
1.	Shpenzime personeli	25.8	1.35
	-Shpenzime per paga	22.8	1.19
	-Shpenzime per sig.	3.0	0.16
2.	Shpenzime te tjera korente	1373.6	71.53
	-Shpenz operativ+mirembajtjen	371.2	19.33
	-Subvencionet	500.0	26.04
	-Transfertat e brendeshme	415.6	21.64
	-Transfertat e jashtme	79.5	4.14
	-Transfertat tek familjaret/individ.	7.3	0.38
3.	Investime	521.1	27.14
	-Te patrupezuara	9.7	0.51
	-Te trupezuara	511.3	26.63
	TOTALI	1920.4	100.0

Rreth 516 milione leke ose rreth 24.3 perqind e fondit rezerve i jane dhene Ministrise se Transportit, per pagesen e detyrimeve per energji elektrike te shoqerive te ujesjellsave

Rreth 20.9 % e fondit rezerve, ose rreth 443.1 milione leke i jane dhene Ministrise se Brendshme, nga te cilat permendim fondet per emergjencat civile ne qarkun e Shkodres, per te perballuar situaten e shkaktuar nga permytjet natyrore; fondet per demet e shkaktuara ne objekte, prone private, si rrjedhoje e termetit, ne Qarkun e Dibres; fondet per komunen Paskuqan, per zbatimin e projektit emergjent "Rreshqitja e varrezave ne Paskuqan, per marrjen e masave rehabilituese dhe mbrojtese"; fondet per zbatimin e projektit "Rehabilitimi i mbulesave te pallateve ne lagjen nr.1, Kukës"; fondet per Bashkine Kruje, te qarkut te Durrësit, per zbatimin e projekteve emergjente, qe lidhen me marrjen e masave rehabilituese dhe mbrojtese nga fatkeqesi te ndryshme; per dhenie ndihme financiare familjes se Z.Gjetan Pjeter Lala, te ciles i eshte demtuar banesa nga fatkeqesite natyrore; per dhenie ndihme financiare

familjes se Z.Artur Kaja, te ciles iu shkaktuan dy viktima dhe tre te plagosur rende nga zjarri i rene ne banese, me date 22.11.2009; per realizimin e nje spoti publicitar per informimin e shtetasve shqiptare ne kuader te procesit te liberalizimit te vizave, per dhenie fondi Keshillit te Qarkut te Lezhes, per rindertimin e kembeve te ures se Gallates dhe montimin e ures tip "BEILI", per dhenie ndihme financiare nje kategorie personash te strehuar ne Republiken e Shqiperise, etj.

Rreth 244 milione leke ose rreth 11.5 perqind i eshte akorduar Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatoreve, per nderhyrjet emergjente ne objektet e mbrojtjes nga permbytja dhe digat e rezervuareve dhe per Autoritetin Kombetar te Ushqimit.

Per Kryeministrine eshte perdorur rreth 9.7 perqind e ketij fondi ose rreth 206.6 milione leke.

Rreth 55.4 milione leke ose 2.6 perqind e ketij fondi eshte perdorur per dhenie ndihme financiare qeverise se Kosoves, per realizimin e projekteve te propozuara per komunen Gracanice, Kosove.

Rreth 53.4 milione leke ose rreth 2.5 perqind e fondit rezerve eshte perdorur per nje shtese ne buxhetin e vitit 2010, per Ministrine e Drejtesise, per mbulimin e shpenzimeve te qirase se zyrave te misionit EURALIUS, etj.

Ne sektorin e shendetesise, eshte akorduar rreth 52.6 milione leke ose rreth 2.5 perqind e totalit te fondit rezerve te Keshillit te Ministrave. Ky fond ka sherbyer kryesisht per te perballuar shpenzimet, te cilat lidhen me kurimin e njerezve, qe kane patur nevojte per kurim jashte vendit dhe per mbulimin e shpenzimeve per kryerjen e implantimit koklear, per disa femije.

Rreth 152.1 milione leke ose rreth 7.2 perqind e fondit rezerve te Keshillit te Ministrave, i jane akorduar Ministrise se Financave, per kryerjen e rikonstruksionit te Akademise se Trajnimeve te Administrates Tatimore dhe Doganore, per ekzekutimin e vendimeve gjyqesore, per dhenie ndihme financiare qeverise se Republikes se Moldavise dhe qeverise se Republikes Islamike te Pakistanit, per lehtesimin e pasojave, te shkaktuara nga permbytjet.


Tabela e meposhtme jep nje pasqyre me te plote te perdorimit te ketij fondi, sipas institucioneve per periudhen janar-shtator 2010.

Perdorimi i Fondit Rezerve	Nr. vendimesh	Ne milion leke	Ne perqindje
Kryeministria	4	206.6	9.7
Ministria e Ekonomise	1	19.0	0.9
Ministria e Bujqesise	2	244.0	11.5
Ministria e Transportit	3	516.0	24.3
Ministria e Financave	6	152.1	7.2
Ministria e Shendetesise	13	52.6	2.5
Ministria e Drejtesise	3	53.4	2.5
Ministria e Brendeshme	20	443.1	20.9
Instituti i Statistikave	1	39.2	1.8
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	1	55.4	2.6
KQZ-ja	1	3.9	0.2
Ministria e Integritit	2	29.6	1.4
MTKRS dhe MPCSSHB	3	63.1	3.0
Te tjera	4	241.6	11.4
Totali	64	2119.5	100.0

Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale deri ne fund te muajit shtator 2010 jane realizuar ne rreth 70.8 perqind te planit vjetor. Brenda ketyre shpenzimeve, investimet me financim te brendeshem jane realizuar ne masen 84.0 perqind, nderkohe qe investimet me financim te huaj jane realizuar ne masen 54.8 perqind te parashikimit vjetor. Krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar investimet e brendeshme rezultojne rreth 22.5 miliarde leke me te ulta ose rreth 39.1 perqind me pak, nderkohe qe investimet me financim te huaj rezultojne rreth 1.2 miliarde leke me te ulta ose rreth 9.7 perqind me pak. Per rrjedhoje, investimet ne total ne fund te muajit shtator 2010 jane rreth 33.7 perqind me te ulta ose rreth 23.8 miliarde leke me pak se ne te njejten periudhe te nje viti me pare.

Figura 17. Shpenzimet kapitale janar-shtator



Struktura e investimeve kapitale te realizuar gjate periudhes janar-shtator 2010 eshte rreth 75.2 perqind nga financimi i brendeshem dhe rreth 24.8 perqind nga financimi i huaj.

Ecuria e investimeve kapitale me financim te brendeshem dhe me financim te huaj gjate nentemujoreve te pare ne disa vite jepet nga grafiku i meposhtem.

Figura 18. Financimi i investimeve publike janar-shtator

